



## Njoftim për zgjedhjet studentore 2018

Bazuar në dispozitat e Statutit të Përkohshëm të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF), si dhe Rregullores për Zgjedhjet Studentore, Këshilli Drejtues (KD) i UShAF, në mbledhjen e mbajtur me datën 22.08.2018, ka marrë vendim për shpalljen e zgjedhjeve studentore për anëtarë të Parlamentit Studentor, të cilat do të mbahen me 18.09.2018.

Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj inkurajon të gjithë studentët e Universitetit që të marrin pjesë në zgjedhje dhe të votojnë organizatën, respektivisht kandidatët e nominuar në organizatën përkatëse, që ata mendojnë, se më së miri do t'i përfaqësojnë interesat e tyre përmes Parlamentit Studentor në Këshillin Mësimor/Shkencor dhe Senat të Universitetit.

Universiteti inkurajon kandidimin e studentëve më të mirë dhe të gjitha Organizatat Studentore, të cilat në programet e tyre nuk kanë agjendë politike, fetare dhe racore, që denjësisht t'i përfaqësojnë dhe mbrojnë interesat e studentëve.

Organizatat studentore, të interesuara për të marr pjesë në Zgjedhjet Studentore për anëtar të Parlamentit Studentor të UShAF, do të certifikohen nga Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ) me datën 03.09.2018. Paraprakisht Organizatat Studentore duhet të jenë të regjistruara në Ministrinë e Administratës Publike, konform Ligjit për Lirinë e Asociimit në organizatat joqeveritare. Me rastin e aplikimit për certifikim në KQZ, Organizatat Studentore të regjistruara për herë të parë, duhet të dorëzojnë edhe listën e deklarimit të studentëve në mbështetje për certifikimin e Organizatës Studentore për Zgjedhjet Studentore 2018, me më së paku 100 nënshkrime për certifikim për Zgjedhjet e Parlamentit Studentor.

Po ashtu, anëtarët e nominuar në listat e Organizatave Studentore për anëtarë të Parlamentit Studentor, duhet të jenë të nënshkruara dhe çdo kandidat i nominuar në listë duhet të ofrojë deklaratë se pranon kandidaturën.

Për informata më të hollësishme lidhur me kërkesat për aplikim dhe për zbatimin e procesit zgjedhor, kontaktoni në email adresën [info@ushaf.net](mailto:info@ushaf.net).

